



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT  
(Përfundimtar)**

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL**

**BASHKIA TIRANË**

**NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.4  
(NJËSIA BASHKIAKE NR.4 TIRANË)**

**Tiranë, Shtator 2015**

## RAPORT

### Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil Njësia Administrative nr.4, Tiranë

#### Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe planit të mbikëqyrjes, me vendimin nr. 38, datë 23.04.2015 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Njësia Bashkiake nr.4, Tiranë”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Njësine Bashkiake nr.4, Tiranë.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial që kanë pësuar njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, njësitë bashkiake, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, “Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”, pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, “Transferimi i personelit”, parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njësive që janë shkrirë dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riformatimit të njësive të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për miratimin e raportit përfundimtar, do t’i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, si institucioni përgjegjës në këtë rast.

Mbikëqyrja në këtë rast u realizua sipas programit të mbikëqyrjes nr. 334/2 prot., datë 23.04.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 334 prot., datë 23.04.2015 “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil dhe zbatimin e tij gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Valentina Kolleshi dhe Matilda Idrizaj, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Mbikëqyrjes, Arbana Basha, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në këtë institucion, të cilin ia ka dërguar për njohje, me shkresën nr. 334/3 prot., datë 30.07.2015, duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Në vijim të procesit, nga ana e subjektit të mbikëqyrur, me shkresën nr. 02/1 prot., datë 06.08.2015, është kthyer projektraporti i pa nënshkruar dhe pa observacione.

Në shkresë argumentohet se, në mbështetje të nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 44/2 të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, Njësia Administrative, nuk është organi kompetent të shprehet për ligjshmërinë ose jo të administrimit të shërbimit civil në ish Njësinë Bashkiake nr. 4, Tiranë dhe ka njoftuar për aktin Bashkinë Tiranë.

Në këto rrethana, Komisioneri, duke e vlerësuar si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar, e për këtë arsye vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes:**

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Objekti i mbikëqyrjes:**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
  - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, dt.11.11.1999 ”*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
  - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
  - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil.
  - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
- Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
  - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013 ”*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar,
  - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 ”*Për nëpunësit civil*”.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm*).

10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil; si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësisë përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes:**

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në subjekt të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me personin e kontaktit që ishte Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, ku u bisedua dhe u ra dakord për objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes si dhe për dokumentacionin shkresor që duhet të vihet në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- Grupi i punës verifikoi pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit;
- U verifikuan procedurat e rekrutimit sipas procedurave konkurruese, të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”;
- U verifikuan dosjet individuale të çdo nëpunësi civil si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si arsimit, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi 1 dhe Aneksi 2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij projektraporti.

## **Përmbajtja e raportit:**

### **I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit.**

#### **a. Vlerësimi i procesit të ndarjes së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në institucion, sipas strukturës aktuale.**

Njësia Bashkiake nr. 4, Tiranë, tashmë është pjesë e njësisë së qeverisjes vendore, në përbërje të Bashkisë Tiranë, ndërkohë që para konstituimit të organeve të qeverisjes vendore, pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, statusi i këtij subjekti përcaktohej në ligjin nr.8654, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, (i shfuqizuar).

Në nenin 13 të këtij ligji përcaktohej në mënyrë të shprehur se, “organet e njësisë bashkiake dhe administrata e tyre përfitojnë të drejta, si ato të bashkive të tjera të vendit, përsa i përket trajtimit të tyre”. Ligji nr. 8654, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr.9208, datë 18.3.2004, nenet 5 dhe 6 të tij, e përcaktonte bashkinë si njësi të qeverisjes vendore, e për këtë arsye, hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e përfshin këtë institucion në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Për rrjedhojë, në fushën e veprimit të këtij ligji, përfshihen edhe Njësitë Bashkiake, (aktualisht Njësi Administrative).

Në Bashkinë e Tiranës, në momentin e mbikëqyrjes, funksiononin 11 njësi bashkiake pjesë e qeverisjes vendore dhe administrata e tyre funksiononte mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, sipas parashikimeve të nenit 32, shkronja ”ç” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak.

Në rastin konkret, struktura organizative dhe organigrama e Njësive Bashkiake të Tiranës është miratuar me Vendimin nr. 10, datë 21.03.2005 të Këshillit Bashkiak ”Mbi disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 26.01.2001 ”Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”, e cila, për Njësinë Bashkiake nr. 4, ka miratuar gjithsej **24** pozicione pune.

Kësaj strukture i janë shtuar edhe **4** pozicione pune të miratuara me vendime të Këshillit Bashkiak, që janë, Vendimi nr. 5, datë 05.02.2007 ”Për caktimin e Njësive Bashkiake si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore si dhe për një shtesë në numrin e punonjësve në strukturën organizative”; Vendimi nr. 20, datë 30.04.2007 ”Për kalimin e disa kompetencave njësive bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësive Bashkiake dhe Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit” dhe Vendimi nr. 23, datë 09.04.2013 ”Për një ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 17, datë 28.02.2013...”,

Në strukturën e Njësive Administrative nr. 4, Tiranë, përfshihen edhe **5** pozicione pune që i përkasin Zyrës së Gjendjes Civile (1 pozicion përgjegjës sektori dhe 4 pozicione nëpunës).

Numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile, pranë Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, para miratimit të strukturës provizore, është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1299, datë 16.12.2009 “*Për miratimin e strukturës, të organikës dhe numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarqeve*”.

Në kuptim të ligjit nr. 10 129, datë 11.05.2009 “*Për gjendjen civile*”, shërbimi i gjendjes civile, ushtrohet si funksion i deleguar në organet e qeverisjes vendore.

Struktura e subjektit të mbikëqyrrur, nuk ka pësuar ndryshime, si para dhe pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe rezultoi e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Njesisë, me Vendimin nr. 12, datë 26.05.2014 “*Për miratimin e buxhetit për vitin 2014*”, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë, me shkresën nr. 2451/1 Prot., datë 30.05.2014, për vitin 2014 dhe me Vendimin nr. 1, datë 29.01.2015, “*Për miratimin e buxhetit për vitin 2015*”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. 667/2 Prot., datë 13.02.2015, për vitin 2015.

Mbështetur në aktet rregullative të përmendura më sipër, rezultoi se institucioni i mbikëqyrrur ka gjithsej **35** pozicione pune, të kategorizuara si më poshtë:

- Numri i funksionarëve politikë është **3** (1 kryetar, 1 zv/kryetar, 1 sekretar i këshillit bashkiak);
- Numri i punonjësve administrativë është **11** (1 sekretare e kryetarit, 1 punonjës arke, 1 punonjës biblioteke, 1 shofer, 3 pastruese, 2 roje, 2 punonjës me kontratë nga të ardhurat e Njesisë Bashkiake);
- Numri i nëpunësve civilë është **21**.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese janë **6** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori*” / “*Përgjegjës zyre*”;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **15** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “*Specialist*”.

Sipas strukturës organizative, konstatohet se, në momentin e mbikëqyrjes, **19** pozicione pune rezultojnë të zëna dhe **2** pozicione pune, të lira. Pozicionet e lira i përkasin nivelit të kategorisë ekzekutive: “*Specialist në Sektorin Ekonomik*” dhe “*Specialist në Sektorin e Urbanistikës*”.

Duke i vlerësuar pozicionet e punës në këndvështrim të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” dhe më konkretisht sipas Lidhjes nr. 3

*”Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës”, e cila është pjesë e këtij vendimi, rezulton se 5 pozicione të kategorisë ekzekutive, janë pozicione pune që përfshihen në grupin e administrimit të posaçëm.*

Këto pozicione, në kuptim të ligjit, kërkojnë njohuri të posaçme për të realizuar detyrat funksionale dhe bëhet fjalë për 1 pozicion *“Specialist Finance e Sektorit Ekonomik”, 1 pozicion “Specialist i taksave vendore”, 1 pozicion “Specialist tregu”, 2 pozicione “Specialist i Sektorit të Urbanistikës”.*

**Konkluzion:** Për sa parashtroam më sipër, Komisioneri konstaton se, struktura organizative për administratën e institucionit të mbikëqyrur është e organizuar mbështetur në parimin e hierarkisë, në përmbajtjen e saj prezantohen niveli i funksionarëve politikë, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë. Numri i punonjësve për çdo njësi organizative është brenda kufirit të miratuar.

- b. Plotësimi i kushteve ligjore për të përfutur statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.*

Nisur nga fakti që subjekti i mbikëqyrur, është institucion që përfshihet në fushën e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 *”Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- *pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 *”Statusi i nëpunësit civil”*, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;*
- *pika 4, “nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
- *pika 6, ”Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave *”Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu II “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 *”Statusi i nëpunësit civil”*.*

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil,



nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, grupi i kontrollit ka verifikuar dhe analizuar të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila është aktualisht në fuqi; listëprezencën e muajit shkurt 2014 dhe listëprezencën e muajit mars - prill 2015; dokumentacionin e plotë që pasqyron procedurat e konkurrimit të realizuara për nëpunësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil; përshkrimet e punës për pozicionet e shërbimit civil si dhe dosjen individuale të çdo nëpunësi civil ekzistues.

Në përfundim të kësaj analize, më poshtë po paraqesim mënyrën e plotësimit të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.

**b/1.** Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr.8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Megjithëse subjekti i mbikëqyrur, është institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe më parë, sipas ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil", nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësve aktualë, rezulton se, në këtë institucion nuk është zhvilluar asnjë procedurë konkurrimi për pranimin në shërbimin civil.

**b/2** Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë të emëruar me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se në **10** raste, pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Megjithëse kjo dispozitë ligjore përcaktonte konkurrimin, si të vetmen mënyrë të rekrutimit në shërbimin civil, marrëdhëniet e punës për këta punonjës, kanë vazhduar të rregullohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se:

- i.** në **6** raste, punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më pak se 1 vit.

Bëhet fjalë për punonjësit, në pozicionet e punës si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , "Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik", emëruar me Vendimin nr.29, datë .26.04.2013 të Kryetarit;
- \*\*\*\*\* , "Specialiste e Zyrës së Ndhmës Ekonomike", emëruar me Vendimin nr. 48, datë 16.08.2013, të Kryetarit;
- \*\*\*\*\* , "Specialiste e Taksave Vendore", emëruar me Vendimin nr. 56, datë 12.09.2013, të Kryetarit;

- \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës”, emëruar me Vendimin nr. 38, datë 15.05.2013, të Kryetarit;
- \*\*\*\*\* , “Specialiste e Sektori të Urbanistikës”, emëruar me Vendimin nr. 36, datë 02.05.2013, të Kryetarit;
- \*\*\*\*\* , “Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve”, emëruar me Urdhrin nr. 737, datë 05.06.2013, të Kryetarit.

Nga këqyrja e dokumentacionit të dosjeve personale rezulton se, momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, i ka gjetur këta punonjës në një pozicion pune, ku periudha e punësimit ka qenë më e vogël se një vit.

- ii. në 4 raste, punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më tepër se 1 vit.

Bëhet fjalë për punonjësit në pozicionet e punës si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , “Specialist në Sektorin e Urbanistikës”, emëruar me Vendimin nr. 10, datë 13.01.2012, të Kryetarit;
- \*\*\*\*\* , “Specialist në Sektorin e Urbanistikës”, emëruar me Vendimin nr. 56, datë 12.09.2012, të Kryetarit;
- \*\*\*\*\* , “Specialist në Zyrën e Ndihmës Ekonomike”, emëruar me Vendimin nr. 75, datë 09.09.2011, të Kryetarit;
- \*\*\*\*\* , “Specialiste e Arkiv-Protokollit”, emëruar me Vendimin nr. 5, datë 25.05.2006, të Kryetarit.

Duke u nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se, momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri (data 26.02.2014), i ka gjetur këta punonjës në një pozicion pune, ku periudha e punësimit ka qenë më tepër se një vit.

Aktet, të cilat materializojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën **Aneksi nr. 1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, grupi i punës konstaton se, Sektori i Burimeve Njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit aktualë që do të quhen nëpunës civilë për shkak të ligjit të ri, nuk e ka kryer këtë proces.

Gjithashtu, konstatohet se nuk ka materiale shkresore që të provojnë **a)** shtyrjen e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit si dhe **b)** shkaqet apo arsyet e kësaj shtyrje.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-teritorial”, Kreu IV, gërma ”c”, është përcaktuar shprehimisht se :

*“Për punonjësit që mbulojnë pozicione të shërbimit civil, por njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, nuk është shprehur në lidhje me statusin e tyre të punësimit, sipas ligjit nr.152/2013, ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e bashkisë, merr funksionet e organit përgjegjës dhe shprehet në lidhje me statusin e tyre të punësimit.”*

Mbështetur në sa më sipër, është detyrë e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Bashkinë e Tiranës, e cila ka marrë funksionet e organit përgjegjës, të kryejë procedurën e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit dhe punonjësit aktualë, të Njesisë Administrative nr. 4, Tiranë, sipas kërkesave të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**Konkluzion:** Në rrethanat që i parashtrua më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë, e cila tashmë ka marrë funksionet e organit përgjegjës, duhet të kryejë procedurën e deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit dhe punonjësit aktualë, sipas kërkesave të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**iii.** Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë emëruar me akte emërimi të përkohshme, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (pas datës 26.02.2014), konstatohet se në institucionin e mbikëqyrur, në **3** raste, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme, të cilat pasqyrohen si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , i cili, me aktin nr. 14, datë 06.05.2014, është emëruar “Jurist” dhe më pas, me vendimin nr. 38, datë 22.09.2014 të titullarit të institucionit, është emëruar “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”;
- \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin “Specialist i Taksave të Tregut” me vendimin nr. 9, datë 03.03.2014 të titullarit të institucionit;
- \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike”, me vendimin nr. 39, datë 22.09.2014 të titullarit të institucionit;

**Konkluzion:** Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit për punonjësit e mësipërm, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Në këtë rast, rekomandohet njësia përgjegjëse në Bashkinë Tiranë, që për rregullimin e situatës, të revokojë aktet e emërimit për punonjësit \*\*\*\*\*.

Si rrjedhim, pozicionet e mësipërme si “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, “Specialist i Taksave të Tregut”, “Përgjegjës i Zyrës Juridike”, duhet të shpallen vende të lira, me qëllim që të plotësohen në përputhje me procedurën ligjore.

- Rasti i emërimit të punonjësës \*\*\*\*\*.

Konstatohet se punonjësja \*\*\*\*\* me vendimin nr. 14, datë 11.03.2014 të titullarit të institucionit, është punësuar me emërim të përkohshëm, në pozicionin “Specialiste në Zyrën e Ndihmës Ekonomike” (Ky rast është trajtuar më poshtë në material si emërim, në zbatim të një vendimi gjykate).

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe nga komunikimi me Përgjegjësën e Sektorit të Burimeve Njerëzore, grupi mbikëqyrjes ka rënë në dijeni të faktit se, për punonjësën \*\*\*\*\* ka një vendim gjykate të formës së prerë, që ka vendosur për kthimin e saj në pozicionin e punës, “Administratore e Ndihmës Ekonomike”, në Bashkinë Burrel dhe pagimin e pagës, nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, deri në ekzekutimin e këtij vendimi (bëhet fjalë për Vendimin nr. 6, datë 03.02.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë).

Në nenin 66/1 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se :

1. Vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, zbatohen menjëherë nga njësia përgjegjëse.
2. Nëse rikthimi i nëpunësve në detyrë është objektivisht i pamundur, atëherë ata regjistrohen në listë pritje, deri në sistemimin e tyre në një pozicion të rregullt në shërbimin civil. Lista administrohet nga njësia përgjegjëse.
3. Gjatë kohës së qëndrimit në listë, nëpunësit civilë paguhen sipas pozicionit të fundit që kanë pasur në shërbimin civil.

Pra, në kuptim të ligjit, vendimi gjyqësor i formës së prerë për nëpunësen \*\*\*\*\* duhet të ekzekutohej nga Bashkia e Burrelit dhe më tej, të vijonin procedurat për lëvizjen e punonjësës në një njësi tjetër të qeverisjes vendore, në përputhje me kërkesat e ligjit.

Ndërkohë, rezulton se me shkresat nr. 682 prot., datë 30.03.2015 dhe nr. 682/1 prot., datë 16.04.2015 “Kërkohet informacion nbi punonjësën \*\*\*\*\*”, i është kërkuar Departamentit të Administratës Publike, informacion nëse vendimi i konfirmimit si nëpunëse civile, dhënë nga Bashkia Burrel, në datën 08.10.2003, për nëpunësen \*\*\*\*\* është në fuqi.

Në shkresën kthim përgjigje nr. 1286/1 prot., datë 15.04.2015, Departamenti i Administratës Publike, thekson se, marrëdhënia e shërbimit civil në institucionet e pavarura, në rastin konkret njësitë bashkiake, administrohet nga njësia përkatëse e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Pra, në këtë rast, njësia përgjegjëse në Bashkinë Tiranë, duhet të kërkojë informacion nga Bashkia Burrel, në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor për nëpunësen \*\*\*\*\* dhe

më tej, të vijojë me nxjerrjen e një akti përfundimtar, në lidhje me marrëdhënien e punës për këtë punonjëse, si nëpunëse civile.

**Konkluzion:** Përsa më sipër, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse në Bashkinë Tiranë, që, për të rregulluar ligjshmërinë në lidhje me marrëdhëniet e punës për nëpunësen \*\*\*\*\* në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, të verifikojë procedurën e kryer nga Bashkia Burrel, në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 6, datë 03.02.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pasi nga zbatimi i tij, lindin të drejta dhe detyrime që kanë të bëjnë me pagesën e pagës dhe më tej, vlerësimin e statusit të punësimit të kësaj punonjëseje.

**iv.** Pozicione pune që përfshihen për herë të parë në fushën e veprimit të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Ashtu siç e analizuam në hyrje të këtij materiali, në strukturën e subjektit të mbikëqyrjes, përfshihet edhe Zyra e Gjendjes Civile, e cila hyn për herë të parë në skemën e shërbimit civil.

Zyra e Gjendjes Civile, në institucionin e mbikëqyrur, përbëhet nga **5** pozicione pune, ku janë punësuar punonjësit si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”;
- \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist në Zyrën e Gjendjes Civile”.

Për këta punonjës, pas verifikimit të dokumentacionit të punësimit rezultoi se:

- a.** në **3** (tre) raste punonjësit ekzistues që janë të punësuar në të njëjtin vend pune, kanë një periudhë më tepër se 1 vit.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

\*\*\*\*\* “Specialiste e Gjendjes Civile”, emëruar me Vendimin nr. 27, datë 01.08.2011, të Kryetarit;  
\*\*\*\*\* “Specialiste e Gjendjes Civile”, emëruar me Vendimin nr. 70, datë 14.11.2011, të Kryetarit;  
\*\*\*\*\* “Specialiste e Gjendjes Civile”, emëruar me Vendimin nr. 75, datë 16.11.2012, të Kryetarit.

- b.** Konstatohet se në **2** (dy) raste, punonjësit janë emëruar pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pra, pas datës 26.02.2014.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist i Gjendjes Civile”, emëruar me Vendimin nr. 6, datë 04.02.2015, të Kryetarit;

- \*\*\*\*\* “*Specialist i Gjendjes Civile*”, emëruar me Vendimin nr. 2, datë 19.01.2015, të Kryetarit.

Duke analizuar aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj strukture, rezulton se shërbimi i gjendjes civile, në kuptim të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “*Për gjendjen civile*”, ushtrohet si funksion i deleguar në organet e qeverisjes vendore.

Sipas nenit 61 të këtij ligji, gërma “c”, *shërbimi i gjendjes civile, funksionon edhe në njësitë bashkiake, i organizuar si Zyra të Gjendjes Civile.*

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile në Njësitë Bashkiake, deri në datën 26.02.2014, janë rregulluar sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si pasojë e zgjerimit të fushës së shërbimit civil, u përfshinë në skemën e shërbimit civil edhe Zyrat e Gjendjes Civile në Njësitë Bashkiake. Kjo për faktin se në nenin 2 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është parashikuar në mënyrë të shprehur se, fusha e veprimit të tij, shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Më tej, në nenin 65 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “*Për gjendjen civile*”, përcaktohet se, rekrutimi i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave konkurruese, të caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, që është edhe organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile dhe një institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Në këto rrethana, duke pasur parasysh faktin që, emërimi i punonjësve të shërbimit të gjendjes civile, kryhet mbi bazën e një procedure konkurruese të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, si dhe përfshirjen e këtyre pozicioneve në kategorinë e funksioneve që ushtrojnë autoritet publik, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo strukturë duhet të përfshihet në shërbimin civil.

Për punonjësit e punësuar në këto pozicione pune, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, njësia përgjegjëse, duhet të kishte bërë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të deklaronte statusin e punësimit.

Gjithashtu, për pozicionet e punës së Zyrës së Gjendjes Civile, ashtu si dhe për pozicionet e tjera të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk ka hartuar përshkrimet e reja të punës, sipas formatit standard të miratuar, siç përcaktohet në aktin përkatës nënligjor.

Nga ana tjetër, konstatohet se aktet rregullative të shërbimit të gjendjes civile, përcaktojnë se shërbimi i gjendjes civile ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile, përcaktohet me akt nënligjor nga Këshilli i Ministrave.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile si organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile, realizon drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile. Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, realizohet nga kryetari i njësisë

bashkiake, sipas kritereve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile, është kompetencë e kryetarit të njësisë bashkiake, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Sipas sqarimeve të dhëna nga njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion, faktin që nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil për këtë kategori nëpunësish, e argumenton me pretendimin se menaxhimi i kësaj zyre, lidhur me rregullat, kushtet dhe procedurat e pranimit të nëpunësve në shërbimin e gjendjes civile, administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 7, pika 2, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, ka përcaktuar detyrat e Departamentit të Administratës Publike, ndër të cilat, në gërmën “f” të kësaj dispozite, në mënyrë të shprehur përcaktohet se Departamenti i Administratës Publike *“mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji”*.

Në këto rrethana, institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (*që është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile*) dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme (*sekretari i përgjithshëm është organi që vjen menjëherë si epror i Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile*) dhe Departamentin e Administratës Publike, duhet të qartësojnë pozicionin e nëpunësve të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil dhe më tej, të vijojnë me procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, për punonjësit që kanë mbajtur këto pozicione pune në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 67, të tij, si dhe VKM-së nr. 116, datë 05.03.2014 *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*.

Në lidhje me rastin e punonjësve të gjendjes civile, konstatohet se në momentin e mbikëqyrjes, punonjësja \*\*\*\*\* kryen detyrën *“Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”*, e emëruar në këtë pozicion me vendimin nr. 58, datë 20.10.2014 të Kryetarit të Njësisë Bashkiake, ndërsa momenti i fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil, pra, data 26 Shkurt 2014, e ka gjetur në pozicionin e punës *“Specialiste e Gjendjes Civile”*.

Edhe ky rast, duhet të trajtohet pasi të sqarohet më parë pozicionimi i nëpunësve të zyrës së Gjendjes Civile, në sistemin e shërbimit civil. Ky rast është trajtuar hollësisht në material në kapitullin, *“Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyre, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”*.

## **II. Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.**

Një institut shumë i rëndësishëm, i cili ka lidhje me një sërë institutesh të tjera të ligjit për nëpunësin civil, të tillë si rekrutimi, ristrukturimi, vlerësimi i punës, sistemi i karrierës etj., është edhe procesi i hartimit të përshkrimit të punës, për pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil. Akti i përshkrimit të punës, duhet të përmbajë jo vetëm detyrat e nëpunësit, por edhe vendin që zë pozicioni në sistemin e shërbimit civil të institucionit, pra pozicioni organizativ, pozicionimi në shkallën përkatëse, misioni i institucionit, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës,

përgjegjësia për organizimin e punës dhe detyrat kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi (në rastet kur ka), kushtet e punës, kërkesat e posaçme dhe nënshkrimi.

Nga verifikimi u konstatua se, për 21 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil, nga ana e institucionit nuk janë hartuar përshkrimet e punës.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, përshkrimet e punës, hartohen sipas formatit standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura “ dhe lidhjes 4 bashkëlidhur këtij vendimi.

Nisur nga përmbajtja e këtij vendimi si dhe Udhëzimit nr.2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “ Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil ”, si akte nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19 të ligjit 152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhen përcaktuar me hollësi procedurat për hartimin e përshkrimit të punës për çdo pozicion që përfshihet në shërbimin civil.

**Konkluzion:** Sa më sipër, Komisioneri, rekomandon Njësinë e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë, që në koherencë të plotë me riorganizimin e institucionit, të hartojë përshkrimet e reja të punës për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas formatit standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura “ dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr.2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Për pozicionet e punës së Zyrës së Gjendjes Civile, rekomandohet që ky proces të kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe me Departamentin e Administratës Publike.

### **III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimi në shërbimin civil.**

Referuar nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”, çdo institucion, pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë planin vjetor, duke planifikuar nevojat për rekrutime të reja të institucionit.

Ky plan hartohet për vitin e ardhshëm dhe miratohet jo më vonë se muaji shkurt, por nga verifikimi i dokumentacionit në këtë institucion, nuk rezulton të jetë hartuar plani vjetor i nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin 2015.

**Konkluzion:** Nga sa më sipër, Komisioneri, rekomandon njësinë përgjegjëse, që të hartojë planin vjetor të nevojave për rekrutimin në shërbimin civil, duke përfshirë edhe administratën e subjektit të mbikëqyrur, mbi bazën e kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 ”Për nëpunësin



civil”, i ndryshuar si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave ”Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

**IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyre, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.**

a) Raste të lëvizjes paralele

Nga këqyrja e dokumentacionit, konstatohet se, pas fillimit të shtrirjes së efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, në institucionin e mbikëqyrur, në 2 raste, në pozicionet e lira, janë emëruar punonjës si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , e cila më parë kryente detyrën “Specialiste e Zyrës së Ndhmës Ekonomike” dhe me vendimin nr. 47, datë 22.09.2014, të titullarit të institucionit, është emëruar në pozicionin “Specialiste Finance në Sektorin Ekonomik”.
- \*\*\*\*\* , i cili më parë kryente detyrën “Specialist i Zyrës së Urbanistikës” dhe me vendimin nr. 13, datë 11.03.2015, është emëruar në pozicionin “Specialist në Zyrën e Ndhmës Ekonomike”.

Duke ju referuar nenit 25 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, i cili ka qenë në fuqi në momentin e nxjerrjes së aktit të emërimit, plotësimi i pozicioneve të lira të punës, fillimisht bëhet nëpërmjet lëvizjes paralele, për nëpunës të konfirmuar si nëpunës civil në të njëjtën kategori. Në përmbajtjen e këtyre akteve ligjore e nënligjore, është parashikuar procedura që duhet të ndiqet gjatë këtij procesi, si dhe kushtet që duhet të përmbushë një nëpunës për të përfituar nga lëvizja paralele. Në rastin konkret, nuk rezulton të jetë ndjekur kjo procedurë.

Për më tepër, nisur nga fakti që këta nëpunës nuk janë konfirmuar si nëpunës civilë, nuk mund të jenë kandidatë të procedurës së lëvizjes paralele, që është kusht paraprak për realizimin e kësaj procedure, në zbatim të pikës 2, Kreu VI, “Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori”, të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, me përjashtim të rasteve kur ka vendim të veçantë të organit kompetent. Në këtë rast nuk u evidentua një procedurë e tillë.

Nga ana tjetër, këto akte nuk mund të klasifikohen as si raste të transferimit të përkohshëm, për nevoja të institucionit, pasi nuk përmbajnë asnjë element të procedurës që duhet të ndiqet në një rast të tillë. Arrihet në këtë përfundim duke u nisur nga përmbajtja e nenit 48, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe bazuar në kërkesat e Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, ku përcaktohet se, nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në interes të institucionit, së pari, brenda të së njëjtës kategori; së dyti, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve. Rezulton se në këto raste nuk plotësohet asnjë prej këtyre kushteve ligjore.

**Konkluzion:** Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, akti administrativ nr. 47, datë 22.09.2014, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist Finance në Sektorin Ekonomik*” dhe akti nr. 13, datë 11.03.2015, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist në Zyrën e Ndhmës Ekonomike*”, janë akte që kanë dalë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, çka i bën këto akte të pavlefshme.

Në këtë rast, rekomandohet njësia përgjegjëse, që për rregullimin e situatës, të revokojë aktet e emërimit për punonjësit si më sipër, të cilët duhet të kthehen në pozicionet e punës që kanë patur në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Pozicionet e punës “*Specialist Finance në Sektorin Ekonomik*” dhe “*Specialist në Zyrën e Ndhmës Ekonomike*”, në përputhje me riorganizimin e institucionit, duhet të shpallen pozicione të lira, në mënyrë që të plotësohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

b) Raste të ngritjes në detyrë

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, konstatohen 2 raste të emërimit nga pozicioni “*Specialist*”, që është pozicion pune i kategorisë ekzekutive, në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, që i përket nivelit të ulët drejtues. Në rastin konkret janë emëruar punonjësit si më poshtë:

- \*\*\*\*\* , e cila më parë kryente detyrën “*Specialiste në zyrën e ndihmës ekonomike*” (e emëruar me aktin nr.75, datë 09.09.2011) dhe është emëruar në pozicionin “*Përgjegjëse e Sektorit të Ndhmës Ekonomike*”, me vendimin nr. 53, datë 07.10.2014, të Kryetarit të Njesisë Bashkiake.
- \*\*\*\*\* , aktualisht kryen detyrën “*Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile*”, pasi është emëruar në këtë pozicion me vendimin nr. 58, datë 20.10.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake, ndërsa momenti i fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil, pra, data 26 shkurt 2014, e ka gjetur në pozicionin e punës “*Specialiste e Gjendjes Civile*”.

Në kuptim të nenit 26 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të Kreut VII “*Ngritja në detyrë*” të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, i cili ka qenë në fuqi në momentin e daljes së aktit të emërimit, për plotësimin e vendeve të lira nëpërmjet ngritjes në detyrë, për nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, është parashikuar një procedurë, e cila, në këtë rast, nga këqyrja e akteve, nuk rezulton të jetë ndjekur.

Nga ana tjetër, edhe në këtë rast, nuk ndodhemi në kushtet e klasifikimit të aktit si një transferim i përkohshëm, për nevoja të institucionit, pasi nuk përmban asnjë element të procedurës të parashikuar në ligj, ashtu si e argumentuam më sipër në material.

**Konkluzion:** Nga sa analizuam më sipër, vendimi nr. 53, datë 07.10.2014, i titullarit të institucionit, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Ndihmës Ekonomike” dhe vendimi nr. 58, datë 20.10.2014 për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”, janë akte që kanë dalë në kundërshtim me ligjin dhe si të tilla, këto akte duhet të revokohen.

Këta punonjës duhet të kthehen në pozicionet e punës që mbanin para fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Rekomandohet Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Tiranë, si njësi përgjegjëse e ngarkuar nga ligji për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, që në koherencë me riorganizimin e institucionit, pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike” ta shpalli si vend të lirë, për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 242 dt. 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Ndërkohë, procedura për pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”, do të vijojë, pasi të jetë qartësuar pozicioni i zyrave të gjendjes civile, në raport me shërbimin civil, ashtu si e analizuam në pjesën që i përket këtij sektori në material.

#### **V. Procedura e ndjekur nga institucioni në rastet e lirimit nga shërbimi civil, për shkak të dorëheqjes.**

Grupi i punës vëren se, për periudhën objekt mbikëqyrje, në institucionin e kontrolluar, 3 punonjës janë liruar nga detyra për shkak të dorëheqjes dhe marrëdhëniet e tyre me shërbimin civil, kanë përfunduar pas paraqitjes me shkrim dhe miratimit të dorëheqjes, në përputhje me përcaktimet e nenit 64, pika 1 dhe nenit 66, pika 1 gërma “dh” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas listëprezencës së muajit shkurt 2014, rezulton se në këtë subjekt ka pasur 19 nëpunës civil efektiv, ndërkohë që 3 prej tyre, nuk figurojnë në listëprezencën e muajit prillit 2015, të këtij institucioni. Për të sqaruar këtë situatë, u kërkua shpjegim personit të kontaktit, Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe rezultoi se këta punonjës, janë liruar nga detyra për shkak të dorëheqjes.

Për verifikimin e situatës, u këqyr dokumentacioni i nevojshëm që u vu në dispozicion nga personi i kontaktit me institucionin dhe rezultoi se punonjësit :

- \*\*\*\*\* , është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore” në datën 17.02.2014, pas dorëheqjes nga ky pozicion pune të \*\*\*\*\* . Mbi bazën e kërkesës së tij, në datën 05.05.2014 “Për largim nga detyra për arsye personale”, të protokolluar pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore me nr. 680 prot., datë 08.05.2014, është vendosur “Zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës”, me vendimin nr. 16, datë 08.05.2014 të Kryetarit të Njësisë Bashkiake.

- \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist Tregjesh*”, me kërkesën e tij, nr. 303 prot., datë 26.02.2014, ka kërkuar dorëheqjen nga detyra. Me vendimin nr. 8, datë 26.02.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake, është vendosur “*Zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës*” dhe ndërprerja e marrëdhënieve financiare më datë 31.03.2014.
- \*\*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Juriste*”, me vendimin nr. 13, datë 06.05.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake, është vendosur “*Zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës*”. Në këtë akt theksohet se, largimi nga detyra është bërë mbi bazën e kërkesës për dorëheqje, të bërë nga punonjësja në datën 02.05.2014.

Në bazë të dokumentacionit të administruar, konkretisht të listëpagesave të muajit shkurt 2014, konstatohet se në 3 rastet e mësipërme, punonjësit janë nëpunës civilë për efekt të ligjit, në referencë të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Kjo nënkupton faktin se, procedura e largimit për shkak të dorëheqjes, duhet të realizohet duke ju referuar rregullave të përcaktuara në nenin 64 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Nga konstatimi i akteve të largimit, vërehet se baza ligjore që është përdorur nga institucioni për të gjitha rastet e largimit nga detyra, me arsyen e dorëheqjes, është Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.

**Konkluzion:** Në këto rrethana, Komisioneri arrin në përfundimin se nga ana e institucionit nuk është kuptuar dhe zbatuar drejt procedura që duhet të ndiqet në rastet e dorëheqjes. Nisur nga fakti që punonjësit e mësipërm, në bazë të ligjit, janë nëpunës civilë, duhej që procedura e ndjekur të referohej tek ligji për nëpunësin civil dhe jo në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë. Mos deklarimi në kohë i statusit të punësimit në këtë rast, ka pasqyruar edhe zbatimin e Kodit të Punës për rastet e përmendura, duke mohuar të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil, që lindin për shkak të zbatimit të institutit të dorëheqjes.

#### **VI. Procedura e ndjekur nga institucioni për rastet e masave disiplinore.**

Pas verifikimit të dokumentacionit, rezulton se në Njësinë Bashkiake nr. 4, Tiranë, është aplikuar në 3 raste instituti i masave disiplinore, për nëpunës të shërbimit civil, të cilët kanë qenë punonjës efektivë në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Bëhet fjalë për procedurat që do të paraqesim hollësisht më poshtë:

- Punonjësja \*\*\*\*\*\*, në momentin e fillimit të ecurisë disiplinore ka qenë emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës Ekonomike*”. Me vendimin nr. 34, datë 12.09.2014 të Kryetarit të Njesisë, është marrë masa disiplinore “*Vërejtje*” me motivacionin “*Për sjellje jo të përshtatshme me publikun*”, i cili i është komunikuar punonjëses me shkresën nr. 1240 prot., datë 12.09.2014.

Mbi bazën e këtij akti, me vendimin nr. 35, datë 12.09.2014, është bërë “*Pezullimi nga detyra*” i punonjëses dhe më tej, me shkresën nr. 1241/1 prot., datë 26.09.2014, është njoftuar fillimi i procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Kjo procedurë është finalizuar me vendimin nr. 1357, datë 02.10.2014 të Kryetarit të Njesisë Bashkiake nr. 4, ku është urdhëruar zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës për punonjësen e proceduar.

- Punonjësi \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist i Taksave të Tregut*” që është pozicion që bën pjesë në shërbimin civil. Me vendimin nr. 61, datë 10.11.2014 të Kryetarit është marrë masa disiplinore “*Vërejtje*” dhe me vendimin nr. 49, datë 22.09.2014 të Kryetarit, është vendosur “*Pezullimi nga detyra për një afat 30 ditor*”. Më pas, me vendimin nr. 64, datë 31.12.2014, është vendosur lirimi nga detyra.

Duka analizuar procedurën e ndjekur si dhe përmbajtjen e akteve administrative që e materializojnë atë, arrijmë në përfundimin se baza ligjore e ndjekur nga institucioni i mbikëqyrur për kryerjen e ecurisë disiplinore, është Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë.

Në kushtet kur punonjësit e proceduar kanë qenë në pozicione pune të shërbimit civil, atëherë procedura e ndjekur në këtë rast është tërësisht e gabuar dhe në kundërshtim me ligjin. Pavarësisht faktit që punonjësit e mësipërm nuk janë marrë në punë nëpërmjet procedurës së konkurrencës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, pozicionet e punës ku ata i gjeti fillimi i efekteve juridike të ligjit të ri, janë pjesë e shërbimit civil. Për këtë arsye, në zbatim të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, institucioni duhet të kishte bërë deklarinimin e statusit të punësimit për këta nëpunës, akte të cilat nuk rezultojnë të kenë dalë. Më tej, në varësi të rezultateve të procesit, duhet të përzgjidhej edhe procedura që do të ndiqej për dhënien e masave disiplinore.

**Konkluzion:** Përsa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, mos deklarimi i statusit të punësimit, për punonjësit që fillimi i efekteve juridike të ligjit për nëpunësit civil i gjeti në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ka çuar në faktin që procedurat e ndjekura nga Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë, për marrjen e masave disiplinore për punonjësit si më sipër, të mos jenë sipas kërkesave ligjore, të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”.

Në rastin e fillimit të një ecurie disiplinore, ligji parashikon ngritjen e një Komisioni Disiplinor, i cili është një organ disiplinor i përhershëm, që krijohet në çdo institucion. Kompetenca, përbërja dhe procedura që ndiqet nga ky organ, janë të përcaktuara në pikën 3, të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe në pikën 2, Kreu I “*Organet Disiplinore*”, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”.

Nga këqyrja e akteve që materializojnë procedurën e ndjekur gjatë marrjes së masës disiplinore, konstatohet se, nuk është ngritur Komisioni Disiplinor në këtë institucion dhe se të gjitha vendimet për marrjen e masës disiplinore, janë marrë nga Kryetari i Njesisë Bashkiake dhe jo nga eprori direkt, veprime të cilat janë kryer në kundërshtim me ligjin, duke i mohuar punonjësve të penalizuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Në këto rrethana aktet

administrative, në kuptim të nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, janë akte absolutisht të pavlefshme, pasi kanë dalë në kundërshtim me procedurën ligjore.

Në këto raste konstatohet se nuk është bërë ankim në gjykatë nga ana e punonjësve të proceduar disiplinarisht.

- Punonjësja \*\*\*\*\*, fillimisht ka qenë e punësuar si nëpunëse e Zyrës së Gjendjes Civile dhe me vendimin nr. 390, datë 18.02.2014 të Kryetarit të Njesisë, pas miratimit, me shkresën nr. 4324/1 prot., datë 13.02.2014, të Drejtorisë së Përgjithshme së Gjendjes Civile, është vendosur lirimi nga detyra.

Pas fillimit të efekteve të ligjit, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile” dhe me urdhrin nr. 6, datë 10.07.2014 të Kryetarit, është vendosur marrja e masës disiplinore “Vërejtje” me motivacion “për mosrespektim të vazhdueshëm të orarit zyrtar dhe të kohës së punës”.

Më tej, me urdhrin nr. 12, datë 31.10.2014 të Kryetarit, është marrë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” me motivacionin “për plotësim të dokumentacionit ligjor të dosjes personale” dhe me Urdhrin nr. 13, datë 31.10.2014, është vendosur “Pezullimi nga detyra”. Sipas listëpagesave të muajit prill 2015, kjo punonjëse e Njesisë Bashkiake Nr. 4 Tiranë, nuk evidentohet në këtë akt dhe nga ana tjetër, në dosjen e personelit, nuk administrohet një akt për largimin e saj nga detyra.

**Konkluzion:** Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Tiranë, duhet të sqarojë situatën në lidhje me këtë rast dhe të plotësojë dokumentacionin që tregon për historikun e marrëdhënies së punës për këtë punonjëse me subjektin e mbikëqyrur.

#### **VII. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014 për nëpunësit civilë të Njesisë Bashkiake nr. 4, Tiranë.

Nga ky verifikim u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur nuk janë kryer procedurat e vlerësimit për rezultatet në punë të nëpunësve civilë për vitin 2014.

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili i shërben verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit si dhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Vlerësimi i performancës në punë ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil dhe shërben për të marrë vendime objektive edhe në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirimin nga shërbimi civil si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Nisur nga përmbajtja e Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, akt i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 62 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në këtë akt nënligjor është përcaktuar me hollësi procedura e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe kompetencat për vlerësimin.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, formulari i vlerësimit të punës duhet të hartohet sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr.2, pjesë e Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “ *Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”.

Në përmbajtjen e këtij akti, duhet të materializohen të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (*ndarja A*); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (*ndarja B*); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (*ndarja C*); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshhtësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnimin dhe ngritjen profesionale (*ndarja Ç*); vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektiveve kryesorë të punës nga nëpunësit.

Në përfundim të procesit, formularët e vlerësimit duhet të nënshkruhen nga nëpunësit e përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, siç janë “*Zyrtari Raportues*”, “*Zyrtari Kundërfirmues*” dhe “*Zyrtari Autorizues*” dhe ky proces, duhet të përfundojë brenda afateve ligjore të parashikuara.

**Konkluzion:** Komisioneri rekomandon njësinë e përgjegjëse, të kryejë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve për vitin 2014, duke hartuar formularët e vlerësimit të punës, sipas formatit të miratuar dhe në mbështetje të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “ *Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”. Formulari i plotësuar dhe i nënshkruar nga personat e ngarkuar nga ligji, duhet të depozitohet pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dhe të futet në dosjen personale të çdo nëpunësi civil.

## **VIII. Organizimi i Dosjes dhe Regjistrimit të Personelit.**

### **a. Dosja e personelit.**

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen e personelit, si një dokument i krijuar në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, rezulton se në këtë institucion, për të gjithë punonjësit janë pjesë e shërbimit civil, dosja përmban dokumentet e identifikimit (*fotokopje e pasaportës*); dokumente që tregojnë për gjendjen civile (*certifikata e gjendjes familjare*); dokumente që vërtetojnë edukimin arsimor (*diploma e shkollës së lartë*); dokumente që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (*akti i emërimit*); vërtetimi i gjendjes gjyqësore (*Dëshmia e Penalitetit*); vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (*certifikata kualifikimi*), etj.

Mbledhjen e këtyre akteve në dosjen e individuale të nëpunësit civil, e kërkon në mënyrë të shprehur pika 3 e Kreut I, të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit*” si dhe lidhja 1 dhe 2, pjesë të këtij vendimi.

Plotësimi i këtyre kërkesave, në të gjitha rastet, materializohet në mënyrë të detajuar në *Aneksin nr.2* “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas*

*formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake nr. 4”, që është pjesë e këtij materiali.*

Konstatohet se, dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, ai punonjësi që është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore për institucionin.

**b. Regjistri i personelit**

Regjistri i personelit është një dokument i krijuar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Në kushtet kur nuk është bërë ende funksional regjistri qendror i personelit, përgjegjës për administrimin e të cilit është Departamenti i Administratës Publike, verifikimi u përqendrua në regjistrin shkresor të mbajtur nga njësia e burimeve njerëzore, nga ku rezultoi se të dhënat e pasqyruara reflektojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

\*  
\*   \*   \*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë ushtrimit të funksionit të tij të mbikëqyrjes në Njësinë Administrative nr. 4, Bashkia Tiranë, më parë Njësia Bashkiake nr. 4, Tiranë, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas këtij raporti, janë materializuar në tabelën **Aneksi nr. 1** “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe **Aneksi nr.2** “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake nr. 4 Tiranë*”.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**